

Bashkia: FINIQ

Kryetar: LEONIDHA KRISTO

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të përfundohet procesi i ndarjes përfundimtare të tokës në disa fshatra dhe certifikimi i pronave individuale të përfituara nga ligji 7501, si edhe hipotekimi i pronave komunale të cilat janë transferuar tek kjo bashki
2. Do të ngrihet zyra e verifikimit të titujve të pronësisë, në bashkëpunim me grupin e topografëve dhe inxhinierëve
3. Do të blihen makineri për mirëmbajtjen e rrugëve, por edhe për përballimin e situatave emergjente në territorin e bashkisë
4. Do të zbatohen projekte për furnizimin e krahinës me ujë të pijshëm dhe të rrjedhshëm, siç është ujësjellësi rajonal Leshnicë-Dhivër-Livadhja dhe shtrirja e rrjetit shpërndarës në fshatrat e tjera nga burimi i Syrit të Kaltër
5. Do të rikonstruktohet rruga Livadhja-Gravë
6. Do të rikonstruktohet rruga Dermish-Dhivër-Cerkovicë

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të ndërtohen shkolla në territorin e bashkisë në mënyrë që brezi i ri të qëndrojë në këtë bashki, por edhe për të inkurajuar ata që dëshirojnë të kthehen
2. Do të ftohet grupin i MISS ALBANIA 2016, për të vizituar parkun arkeologjik të Finiqit të lashtë si dhe shumë vepra kulturi në Dhrovjan, me qëllim që nëpërmjet këtij aktiviteti të promovohen në mediat vendase dhe të huaja këto vlera të trashëgimisë kulturore
3. Do të ngrihet Grupi Polifonik dhe ai i valleve, duke aktivizuar edhe brezin e ri si nxënësit e shkollave Livadhja, Finiq, Mesopotam
4. Do të hartohet një projekt për krijimin e ambienteve të përshtatshme për ruajtjen, pasurimin dhe promovimin e objekteve të mbledhura nga Shoqata e Mësuesve Pensionistë të Minoritetit Etnik Grek, e cila ka ngritur një muze etnografik në Dermish dhe do të investohet për godinën e re
5. Grupi i këngëve dhe valleve të zonës do të marrë pjesë në aktivitete jashtë shtetit
6. Do të punohet për ndërtimin e qendrës kulturore në Livadhja, në të cilën do të ndërtohet një sallë aktivitetesh 250 vendesh, sallë muzeu si edhe një bibliotekë
7. Do të bashkëpunohet me bashkinë e Dodonës për vendosjen e tabelave treguese, shtrimi i rrugëve brenda parkut arkeologjik si dhe ndërtimi i biletarisë për të krijuar kushte të mira për vizitorët dhe për të shtuar turizmin kulturor të zonës

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të mbrohet dhe zhvillohet tradita dhe kultura e pasur e zonës
2. Do të zbatohen projekte për blerjen e një makine të re pastrimi si dhe një numër të konsiderueshëm koshash

Fusha: BUJQËSI

Preftime:

1. Do të mbrohet dhe promovohet kultura dhe tradita
2. Do të kryhet disiplinim i shfrytëzimit të kullotave dhe pyjeve duke kontrolluar çdo pëllëmbë nga dëmtuesit dhe keq shfrytëzuesit tradicionalë
3. Do të pastrohen kanalet vaditëse, do të përmirësohet ujitja dhe zgjerohet sipërfaqja e mbjellë në territorin e bashkisë
4. Do të synohet rritja e kapacitetit të kullotës dhe përmirësimi i saj

Fusha: TRANSPARENCA

Preftime:

1. Do të zhvillohet shërbimi online për bashkëveprim direkt me qytetarët
2. Do të kryhet eliminim i defekteve dhe borxheve të trashëguara apo të lindura gjatë fushatës, nëpërmjet krijimit të një sistemi elektronik ku do të pasqyrohen të gjitha borxhet e komunave, por edhe të qytetarëve të cilat do të shlyhen në vijimësi jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe si angazhim qytetar

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Preftime:

1. Do të krijohen kushte të përshtatshme jetese për të moshuarit

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Preftime:

1. Do të përkrahen sipërmarrësit e rinj në territorin e bashkisë